



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1557/ 7 prot.

Datë 22.07.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 917/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizim i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK dhe Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë, në procedurën e prokurimit “*E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike*”, me Nr. REF-99889-04-02-2024, me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti I*”, me fond limit **754,965,352.17** (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 7,354,036.16** (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 08.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “A.N.K” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “COBIAL” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike*”, me Nr. REF-99889-04-02-2024, me objekt: “*Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti I*”, me fond limit **754,965,352.17** (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 7,354,036.16** (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 08.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “ARIFAJ” SHPK në procedurën e prokurimit.

**Ankimues:**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK me Nipt J67902928O, L42215009L, J91915001P me adresa: Njësia bashkiake nr. 5, rruga Zef Jubani, ndërtesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019, Tiranë.

Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK me Nipt K61716013M me adresa: Njësia bashkiake nr. 9, rruga Muzakët, pallatet Vokshi, hyrja 1, kati 7, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

**Subjekt i interesuar:**

Operatori ekonomik “A.N.K” SHPK me NIPT J92408001N dhe adresë Tiranë, Rruga e Kavajës, Pallatet Condor, Kulla 1, Hyrja e parë, kati i tretë.

Operatori ekonomik “COBIAL” SHPK me NIPT K02715414M dhe adresë Tiranë, Rruga "Milto Tutulani", Ndërtesa nr.2, H. 19, në Zonën Kadastrale Nr.8270, me Nr. Pasurie 5/336- N16.

Operatori ekonomik “ARIFAJ” SHPK me NIPT J76418907K dhe adresë Tiranë, Rruga Urani Pano, Ap.C-07, Kati gjashtë, Hyrja 10.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Për ankesën me nr. Elektronik A/2024/4197 dhe me nr. 1544/2024 prot, datë 11.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.04.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-99889-04-02-2024, me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti I”, me fond limit **754,965,352.17** (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 7,354,036.16** (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 08.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 08.05.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

II.3. Në datën 29.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “BIBA-X” & “L.T.E CONSTRUCTION” & “K.M.K” & “Caushi M”  
510,357,509.00 lekë, Totali i pikëve të marra: 0 Skualifikuar
2. BOE “S.M.O.UNION” & “SMO VATAKSI” 518,572,205.00 lekë, Totali i pikëve të marra:  
0
3. BOE “ULZA” & “ALMO KONSTRUKSION” & “PEPA GROUP” J679029280 & J91915001P & L42215009L Vlera: 536,822,732.00 (pesëqind e tridhjetë e gjashtë milion e

**tetëqind e njëzetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0**

4. BOE “LIQENI VII” & “VARAKU E” & “KTHELLA” K01730502Ë & J61902509S & J69303023D Vlera: 546,819,966.00 (pesëqind e dyzetë e gjashtë milion e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

5. BOE “S I R E T A 2F” & “LIS KONSTRUKSION” K51501008J & K66613407H Vlera: 555,555,555.00 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

**6. BOE “ARIFAJ” & “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI” J76418907K & K91727010A Vlera: 567,751,800.00 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 228.15**

7. BOE “RSM COMPANY” & “DESARET COMPANY” & “AURORA KONSTRUKSION” 810802422 & K01816001J & K02017003I Vlera: 577,837,155.00 (pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

8. OE “BAMI HOLDING” J94416206R Vlera: 578,398,191.00 (pesëqind e shtatëdhjetë e tetë milion e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

9. BOE “COMPANY RIVIERA 2008” & “BAJRAMI N.” & “AGRI CONSTRUCTION” K81716011V & K02727202O & K01725001F Vlera: 594,862,915.00 (pesëqind e nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

10. BOE “BE - IS SH.P.K” & “CURRI” K71412003A & J67902718S Vlera: 599,741,972.00 (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

11. BOE “NDERTIMI shpk” & “ELMAZAJ KONSTRUKSION” & “NDREGJONI” Vlera: 619,061,100.00 (gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 222.60

12. OE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” K82230002K Vlera: 622,875,579.38 (gjashtëqind e njëzet e dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë tridhjetë e tetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

13. BOE “SHKELQIMI 07” & “GRAND KONSTRUKSION M” K68121808Ë & L38109801T Vlera: 630,000,000.00 (gjashtëqind e tridhjetë milion) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

14. BOE “ALB TIEFBAU” & “MELA.” J66703049C & K62320011G Vlera: 648,009,513.00 (gjashtëqind e dyzet e tetë milion e nëntë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 182.20

15. OE “KUPA” K51615512C Vlera: 649,434,813.30 (gjashtëqind e dyzet e nëntë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e trembëdhjetë pikë tridhjetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

16. BOE “Austria STRABAG AG” & “TREMA ENGINEERING 2” ATU14487107 & K21401004R Vlera: 657,695,858.90 (gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e

nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

**17. OE “PE - VLA - KU” K61716013M Vlera: 664,401,309.98 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e katërqind e një mijë e treqind e nëntë pikë nëntëdhjetë e tetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 226.20**

18. OE “ALBAVIA” J81527001Q Vlera: 671,961,769.50 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

19. OE “A. N. K.” J92408001N Vlera: 709,676,417.94 (shtatëqind e nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 215.55

20. BOE “A.L-ASFALT” & “HTM” & “MF INVEST GROUP” Vlera: 712,246,712.10 (shtatëqind e dymbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë pikë dhjetë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 0

21. OE “COBIAL” K02715414M Vlera: 732,487,538.75 (shtatëqind e tridhjetë e dy milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra: 201.45

II.4. Në datën 05.06.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 30, datë 10.06.2024.

II.5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

*“Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ulza & Pepa Group & Almo Konstruksion” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht; → Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Puna e ngjashme e realizuar gjatë pesë viteve të fundit, e paraqitur nga operatori “Pepa Group” nuk e plotëson vlerën sipas përqindjes pjesmarrëse në kontratën e bashkëpunimit.*

*Gjithashtu, operatori “Almo Konstruksion” nuk përmbush kriterin 2.3.4 “Stafin mbështetës” pasi, staf mbështetës i vetdeklaruar në shtojcën 8, është i angazhuar në një kontratë në proces pranë Autoritetit Kontraktor, kjo në kundërshtim me pikën 2.3.4 ku thuhet; “Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese””.*

II.5.1. Në datën 11.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/4197 dhe me nr. 1544/2024 prot, datë 11.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj, lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe pretendime lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “A.N.K” SHPK dhe operatori ekonomik “COBIAL” SHPK, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi i ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se kësaj të fundit i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II.5.1.1. Përsëri, në datën 13.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/4211 dhe me nr. 1575/2024 prot, datë 13.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj, lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe pretendime lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “A.N.K” SHPK dhe operatori ekonomik “COBIAL” SHPK, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

1. *Referuar arsyes se pare te skualifikimit ku Komisioni Vleresimit te Ofertave ka pretenduar se Puna e ngjashme e realizuar gjatë pesë viteve të fundit, e paraqitur nga operatori ekonomik Pepa Group shpk nuk e plotëson vlerën sipas përqindjes pjesmarrëse në kontratën e bashkëpunimit, sqarojme se ky eshte nje pretendim i cili eshte i pabazuar ne prova dhe fakte.*

*Konkretisht, ne dokumentat standarte te tenderit eshte kerkuar ne piken 2.3.1 qe Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme si me poshte:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pes? viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pes? viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Referuar kerkesave se mesiperme B.O.E. “ULZA” & “ALMO KONSTRUKSION” & “PEPA GROUP” shpk bazuar ne Kontraten e Bashkepunimit date 07.05.2024 ka paraqitur ne kete procedure prokurimi disa kontrata te ngjashme ku vlera monetare totale e puneve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit, eshte me shume se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet, duke plotesuar ne kete menyre piken b) te kerkeses per pune te ngjashme (pika 2.3.1) e cila kerkon punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pes? viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës*

që prokurohet. Konkretisht shoqeria "PEPA GROUP" shpk referuar dhe Kontrates se Bashkepunimit ka marre persiper te realizoje 23% te punimeve objekt prokurimi.

Ne dosjen e tenderit te dorezuar nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomike (BOE) shoqeria "Pepa Group" ka paraqitur dokumentacion te plote per objektet sipas listes se meposhtme :

Nr Punime Pepa Group Emertimi i Kontrates Njesi Vlera e kontrates pa tvsh per Pepa Group shpk

1. Sistemim, asflatim, ndricim i rruges Auto, Lagja e Vjeter Bashkia Fushe Arrez (Pepa Group ka 95% te

vleres se kontrates) Leke 2,964,928

2. Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 1 Leke 45,307,300

3. Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 2 Leke 32,707,814

4. Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 3 Leke 50,379,340

5. Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 4 Leke 29,240,175

6. Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 5 Leke 94,839,251

7. Rehabilitim i rreshqitjes segmenti rugor Qafe mali-Fierze (Pepa Group ka 80% te vleres se kontrates)

Leke 78,004,508

8. Shtese ne pedonale + lulishte ne Qytetin e Fushe-Arrzit (Pepa Group ka 60% te vleres se kontrates)

Leke 3,485,670

9. Ndertimi i objektit "Godine industrial per perpunimin, miksimin dhe paketimin e frutave dhe rrenjeve

1,2,3 kate me vendndodhje Vore (Pjesa e dyte) Leke 72,425,355.38

10 Rikonstruksion kanali, fshati Iballe, Fushe Arrez Leke 24,129,470.58

TOTALI

433,483,812

Mbeshtetur ne kontraten e bashkepunimit dhe ne kerkesat e kualifikimit BOE ka plotesuar kushtin e pervojes "jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet".

Sa me siper shoqeria Pepa Group qe ka marre persiper 23% te punimeve i takon qe te kete shumatore te punimeve te ngjashme ne vleren 347,284,062 Leke.

Theksojme se fryma dhe llogjika e legjislacionit te prokurimit publik dhe me gjere e ka percaktuar qe kur si ekperience merret parasysh shumatorja e disa objekteve atehere duhen pare te gjitha punimet e ketyre objekteve te krahasueshme si nje e tere me punimet e objektit qe pokurohet.

Krahasueshmeria e kontratave nese jane te ngjashme nuk ka te beje vetem me natyren e kontrates nese ajo eshte nje kontrate pune publike, por duhet pare ne lidhje me te gjitha zerat konkrete te punimeve te kryera.

Po te analizojme Preventivin e objektit qe prokurohet sipas kategorive, punimet permbliidhen ne keto zera punimesh:

Kategoria A - Pastrime dhe mbrojtje skarpatash, Ndertesa dhe struktura te tjera (prishje ndertime, mure rrethimi, struktura betoni) etj :

Kategoria B ñ Germime, prishje , mbushje, transport etj

Kategoria C ñ Shtresa cakulli, shtresa zhavori, shtresat asfaltike,transport



*Kategoria D ñ Germime, struktura monolite betoni, tobo betoni dhe celike, punime hekuri, hidroizolim etj.*

*Kategoria E ñ Punime ne trotuar, germime, shtresa cakell, betoni, tubo betoni, shtresa me pllaka sinjalistike rrugore etj.*

*Kategoria F ñ Spostim dhe ndertim linje ujesjellesi dhe ujera te zeza me te gjitha zerat. Kategoria G- Furnizim vendosje kalli optik me te gjitha zerat*

*Kategoria H ñ Rrjeti TU dhe TM me te gjitha zerat Kategoria I - Ndricimi me te gjitha zerat e punimeve.*

*Te gjitha objektet e paraqitura si eksperience nga Pepa Group jane objekte qe kane te gjitha preventivin e punimeve te ngjashem me zerat e punimeve te preventivit te objektit qe prokurohet (cituara me siper).*

*Duke analizuar zerat e punimeve te objekteve qe Pepa Group ka paraqitur si objekte te ngjashme me zerat e punimeve te objektit qe prokurohet, te gjitha punimet ne objektet e paraqitura (10 objektet) jane te ngjashme dhe te perfshira ne objektin e prokurimit :*

*Megjithate per te sqaruar ndonje pasakesi te vleresimit te KVO po mundohemi ti thjeshtojme dhe ti bejme me te kuptueshme si me poshte: Ne listen e objekteve te paraqitur ne tender (me siper) sipas numrave objektet e listuara 1 deri 7 te gjitha keto objekte kane punime te njejta (me shume se te ngjashme jane totalisht te njejta) me objektin qe prokurohet edhe ne emertim duken qarte qe jane te njejta. Pra keto objekte edhe ne forme dhe ne permbajtje jane te njejta me objektin qe prokurohet(Shiko situacionet perfundimtare) .*

*Keto objekte kane punime Germime, mbushje, shtresa rrugore (cakull, stabilizant) shtresa asfaltike, vepra arti ,struktura monolite betoni, tombino etj . Te gjitha keto punime edhe ne emertim jane te ngjashme me objektin qe prokurohet .*

*Vlera totale e objekteve te listes 1-7 = 333,443,316 Leke .*

*Pra vetem kjo liste objektesh 1-7 pothuajse e ploteson vleren e kerkuar me nje diference prej 13,840,746 Leke qe mbeten per dy objektet e tjera.*

*Edhe objektet e tjera te paraqitura ne tender jane punime te ngjashme me objektin qe prokurohet . Per te qartesuar edhe me shume kete po analizojme si me poshte :*

*Objekti nr 8 : Shtese ne pedonale + lulishte ne Qytetin e Fushe-Arrzit (Pepa Group ka 60% te vleres se kontrates) eshte objekt i ngjashem me objektin qe prokurohet : Ne kete objekt perfshihen punime germime , prishje ,transport,trotuare ,ndricim te njejta dhe te ngjashme me punimet e objektit qe prokurohet . Pra edhe ky objekt e ploteson totalisht kerkesen e kualifikimit si objekt i ngjashem. Shuma e objekteve nga 1-8 eshte 336,928,986 leke me nje diference prej 10,355,076 Leke per te plotesuar vleren e kerkuar.*

*Objekti nr 9 :Ndertimi i objektit “Godine industrial per perpunimin,miksimin dhe paketimin e frutave dhe rrenjeve 1,2,3 kate me vendndodhje Vore “ eshte objekt i ngjashem me objektin qe prokurohet:*

*Mbeshtetur ne fakt por edhe ne dokumentat e dorezuara shoqeria Pepa Group shpk ka kryer te gjitha punimet per infrastrukturen e jashtme te nje objekti ndertimi me leje nga KKT-ja.*

*Po te verejme punimet e preventivit te gjitha punimet kane te bejne me punime infrastrukture te jashtme (Emertimi i gjithe Kategorive permban kete percaktim) dhe me konkretisht : Kategorite e punimeve perbehen nga : Punime prishje, germime dhe punime dheu dhe shtresash cakulli etj , transport, punime infrastrukture KUZ dhe KUB, ndertim muri rrethues, ndertim troturari me te*

gjitha shtresat, rrjet kanalizimesh dhe ujesjellesi, punime vepra arti ,struktura monolite betoni etj etj.

Pra te gjitha keto punime jane totalisht te ngjashme me punime e objektit qe prokurohet dhe per te qene me te qarte dhe per te sqaruar Autoritetin Kontraktor theksojme se keto lloj punime jane totalisht te ngjashme me kategorite e meposhtme te preventivit te objektit qe prokurohet por jo vetem:

*Kategoria B Germime, prishje , mbushje, transport etj*

*Kategoria C Shtresa cakulli, shtresa zhavori, shtresat asfaltike,transport*

*Kategoria D Germime, struktura monolite betoni, tubo betoni dhe celike, punime hekuri, hidroizolim etj.*

*Kategoria E ñ Punime ne trotuar, germime, shtresa cakell, betoni, tubo betoni, shtresa me pllaka sinjalistike rrugore etj.*

*Kategoria F Spostim dhe ndertim linje ujesjellesi dhe ujera te zeza me te gjithë zerat. Pamvaresisht se diferenca e punimeve qe nevojitet per te plotesuar vleren e kerkuar te Pepa Group (duke marre objektet 1-8) per kete objekt eshte vetem 10,355,076 Leke, theksojme se vlera e punimeve te ngjashme te ketij objekti e tejkalon disa here kete vlere.*

*Pamvaresisht se vlera e kerkuar per kualifikim eshte e tejkualuar me objektet nga 1 deri ne 8 theksojme se edhe objekti nr 9 “Rikonstruksion kanali, fshati Iballe, Fushe Arrez” eshte objekt i ngjashem , pra edhe objekti nr 9 permban punime te ngjashme me objektin qe prokurohet si punime dherash, pyllzim , punime ne tombino struktura monolite betoni, kanale dhe vepra arti etj.*

*Referuar Ligjit “Per Prokurimin Publik”, rezulton se vendosja e kriterëve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe ti sherbeje Autoritetit Kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomik, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike etj.*

*Sa me siper, Autoriteti Kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale duke ju referuar vetem objektit te kontrates sikunder ka bere ne rastin konkret, por duhet te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit, ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilin vndosen kriteret e percaktura e per pasoje interpretimi i kontratave te paraqitura nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” shpk nese do te cilesohet si experience e ngjashme duhet pare ne raport me natyren e punimeve dhe elementeve konkret te realizimit te tyre (zerat e preventivit) qe Autoriteti Kontraktor synon te arrije te kryeje ne cilesine e “Investitorit”, pas lidhjes se kontrates me operatorin ekonomik te klasifikuar te suksesshem.*

*Shoqeria “PEPA GROUP” shpk verteton nepermjet kontratave te paraqitura se ka kryer pune te ngjashme me objektin e prokurimit e konkretisht ka realizuar ne volume te konsiderueshme zera punimesh te ngjashme me zerat e punimeve te preventivit te publikuar nga Autoriteti Kontraktor per proceduren e prokurimit objekt ankimi. Autoriteti Kontraktor nuk mund te pretendojë zera te ngjashem per te gjithë zerat e preventivit, pasi nje gje e tille te con drejte percaktimit te zerave te njejte, ne kundershtrim kjo me rregullat e prokurimit (pamvaresisht se zerat e objekteve te ngjashem mund te thuhet se jane te njejte me ato te objektit qe prokurohet). Nje percaktim i tille qe ne vetevete nenkupton eksperiencia te njejta apo zera te njejte te puneve bie ne kundershtrim edhe me vete frymen dhe qellimin e Ligjit ne Nenin 2 te tij, duke frenuar konkurrencen ndermjet operatoreve*

ekonomik dhe duke bere nje trajtim jo te barabarte dhe diskriminues te ketyre operatoreve ekonomik pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik.

Per sa me siper, referuar dhe Situacioneve perfundimtare te kontratave te paraqitura nga shoqeria "PEPA GROUP" shpk si dhe preventivit objekt prokurimi, rezulton se zerat e punimeve te kryera jane te ngjashem me zerat e preventivit qe prokurohet. Duke qene se vlera monetare totale e puneve te kryera ne kontratat e mesiperme, e marre sebashku gjate pese viteve te fundit e tejkalon vleren e punimeve prej 23% qe shoqeria "PEPA GROUP" shpk ka marre persiper ne Kontraten e Bashkepunimit, atehere kushti rezulton i permbushur dhe pretendimi i Komisionit te Vleresimit te Ofertave nuk qendron.

2. Referuar arsyes te dyte te skualifikimit ku pretendoni se Operatori "Almo Konstruksion" nuk permbush kriterin 2.3.4 "Stafin mbështetës" pasi, staf mbështetës i vetdeklaruar në shtojcën 8, është i angazhuar në një kontratë në proces pranë Autoritetit Kontraktor, kjo në kundërshtim me pikën 2.3.4 ku thuhet; "Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese", Ju sqarojme se:

Aktualisht BOE "Almo Konstruksion & Deltarex" shpk kane ne proces me Autoritetin Kontraktor kontraten me Nr. 7977/6 prot. Date 20.12.2023 me Objekt : Eliminimi i pikave të zeza (Black Spots), në rrjetin rrugor kombëtar 2023" ne te cilen stafi mbeshtetes eshte plotesuar nga Shoqeria Deltarex shpk. Shoqeria Almo Konstruksion shpk pervec stafit inxhinierik te perfshire ne licencen e shoqerise ne te cilen ka bere ndryshime kohet e fundit (duke larguar Ing.Shaban Bitri) ka deklaruar punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

1. "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" ku eshte angazhuar punonjesi Z.Bashkim Pernezha

2. "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" ku eshte angazhuar punonjesja Znj. Malvina «ollaku.

Ne proceduren e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti 1", shoqeria Almo Konstruksion ka deklaruar si staf mbeshtetes inxhinier ndertimi Z.Shaban Bitri dhe Inxhinier Topograf Z.Renis Alija. Theksojme se inxhinier Z.Shaban Bitri eshte i punesuar vetem si inxhinier dhe jo me drejtues teknik ne licensen e shoqerise (licensa e re ne dosjen e tenderit).

Pra, per sa me siper stafi mbeshtetes inxhinier ndertimi Z.Shaban Bitri dhe Inxhinier topograf Z.Renis Alija te cilet jane te deklaruar si staf mbeshtetes ne proceduren e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti 1", nuk jane te angazhuar ne asnje procedure fituese nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Pra, ne keto kushte rezulton se Ing.Shaban Bitri i deklaruar ne proceduren e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti 1" si staf mbeshtetes nga shoqeria "ALMO KONSTRUKSION" shpk nuk eshte i angazhuar ne kontrata te tjera e per pasoje pretendimi i KVO-se nuk qendron, pasi pika 2.3.4 ku thuhet; "Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, rezulton te jete permbushur nga ana e shoqerise "ALMO KONSTRUKSION" shpk.

Mbeshtetur ne gjithë arsyetimin e mesiperm kundërshtojme vendimin e KVO-se per skualifikimin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik "ULZA" & "ALMO KONSTRUKSION" & "PEPA GROUP" dhe kerkojme kualifikimin e ofertes tone dhe rivleresimin e pikeve te ofertes se

*Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “ULZA” & “ALMO KONSTRUKSION” & “PEPA GROUP”.*

*II. BOE Ulza & Pepa Group & Almo Konstruksion kerkon skualifikimin e operatoreve ekonomike “A.N.K” shpk dhe “COBIAL” shpk dhe rivleresimin me zero pike te ketyre operatoreve ekonomike.*

*Ne arsyetojme se mbeshtetur ne arsyetimin dhe llogjiken e legjislacionit te prokurimit publik se ne procedurat e vleresimit ne rastin e : “ Oferta Ekonomikisht më e Favorshme,bazuar në kosto “ pra vleresimi me pike nuk zbatohet formula per oferte anomalisht te ulet.*

*Duke patur ne vemendje se arsyetimi i mesiperm mund te mos zbatohet nga AK (mbeshtetur kjo edhe ne veprimet e AK pasi edhe ne dokumentat e tenderit ka bere shkelje te hapur te legjislacionit te prokurimi publik si psh mospublikimin e formules per te cilen do te llogariteshin piket per kriteret 4.4.2.b : 4.4.3: 4.4.4) dhe te konsideroje oferten tone anomalisht te ulet , ku si rrjedhoje BOE ka interes te ligjshem per te kundershuar kualifikimin e ketyre operatoreve ekonomik pasi duke zbatuar formulen per oferten anomalisht te ulet , kualifikimi i ketyre operatoreve ekonomike do te sillte klasifikimin tone si oferte anomalisht te ulet. Pamvaresisht se si objekt me vlere me te madhe si kufiri i larte monetar kemi te gjitha argumentat tona qe vlere eshte mese e arsyeshme dhe punimet e ketij objekti plotesisht te realizueshme nga ana jone, perseri duke gjykuar se na cenohet interesi nga kualifikimi jo i ligjshem i ketyre operatoreve, parashtrojme argumentat tona per te kundershuar kete dhe korigjuar kete kualifikim .*

*Mbeshtetur ne arsyetimet e Autoritetit Kontraktor per procedurat qe ky autoritet ka zhvilluar, keto operatore jane shpallur fitues ne dy procedura te vecanta gje e cila passjell edhe angazhimin e mjeteve dhe te stafit te ketyre operatoreve ne kontrata te tjera apo ne procedura te shpallura fitues. Pamvaresisht se mendojme se AK nuk ka zbatuar drejte proceduren e vleresimit ne keto procedura pasi nje operator ekonomik nuk mund te quhet fitues persa kohe nuk ka perfunduar e gjithë procedura e tenderit, perfshi dhe ezaurimin e ankimit dhe shpalljen perfundimtare fitues. Po keshtu duam te theksojme se sipas mendimit tone vleresimi i disa procedurave kur ato behen nga nje Autoritet Kontraktor ne te njejten kohe gjithmone duhet te behet duke patur parasysh interesin ekonomik te AK dhe te buxhetit dhe jo duke planifikuar rradhen e shpalljes se fituesve sipas interesave te dyshimta. Kjo gje mbeshtetur edhe ne eksperiencen e tille me kontratat FIDIC apo me procedura te ngjashme te financuara nga bankat nderkombetare BERZH etj (Autoriteti Rrugor ka eksperience mjaftueshem per te ditur kete metodologji ” most advantageous price “ apo oferta me e favorshme). Kjo gje eshte zbatuar nga autoritete te tjera kontraktore ne raste te ngjashem edhe me buxhetin e shtetit . Permendim kete fakt paraprakisht dhe ruajme te drejten te sqarohemi dhe te ndjekim kete gje deri ne detaje ne vazhdimesi.*

*Kerkojme qe operoret ekonomike “ A.N.K” shpk dhe “COBIAL” shpk te skualifikohen nga kjo procedure dhe te rivleresohet oferta e tyre me 0 pike per keto dy arsye:*

*1. nuk permbush kriterin 2.3.7 “Mjetet dhe pajisjet e kerkuara” pasi, mjetet e vetdeklaruara ne shtojcen 8, jane te angazhuara, kjo ne kundershim me piken 2.3.7 ku thuhet; “Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues”.*

2. nuk permbush piken 2.3.4 “Stafi mbeshtetes”, pasi stafi i vetdeklaruar ne shtojcen 8, eshte i angazhuar, kjo ne kundërshtim me kriteret e kualifikimit. Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Aq me shume qe ne kohen qe shqyrtohet kjo ankese ne KPP shpallja perfundimtare e fituesit per keto procedura duhet te jete realizuar dhe keto shoqeri tashme mund te quhen fitues.

Kerkojme nga KPP-ja qe per vleresimin e pikes III te kerkimeve tona te marre prane AK te gjithë informacionin e duhur per klasifikimet dhe mjetet dhe stafin e angazhuar te ketyre shoqerive.

Kemi besim te plote se drejtuesit e AK do te korigojne kete gabim qe eshte bere me skualifikimin e BOE Ulza & Pepa Group & Almo Konstruksion . Duke pare llogjiken e perdorur por edhe veprimet e KVO-se me kete procedure por edhe me procedurat e tjera te zhvilluara kemi dyshime te forta se keto veprime jane te qellimshme dhe se kemi te bejme me mjaft prova qe vertetojne ndodhjen perpara disa veprave penale si Neni 258 (Shkelja e barazise se pjesemaresve ne tendera apo ankande publike ), Neni 259 (Korrupsion pasiv i personave qe ushtrojne funksione publike) . Sic dihen keto vepra penale hetohen nga organe te specializuara dhe ne per te gjitha keto konstatime per kete procedure dhe me gjere, per te qartësuar te gjithë situaten kemi pergatitur informacionin e duhur per te cilin jemi ne proces perfundimit te tij .

Per sa me siper kerkojme pranimin e ankeses tone, kualifikimin e ofertes tone dhe rivleresimin e pikeve te ofertes se Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “ULZA” & “ALMO KONSTRUKSION” & “PEPA GROUP”, si dhe Skualifikimin dhe rivleresimin me zero pike te ofertes se operatoreve (“A.N.K” shpk dhe “COBIAL” shpk).

II.5.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1544/2 prot., datë 12.06.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1544/2024 prot., datë 11.06.2024. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e ankimuesit, që të skualifikohen operatorët ekonomikë “A.N.K” SHPK dhe “COBIAL” SHPK, për mospërmbushjen e kriterëve 2.3.4 dh 2.3.7 nga ana e secilit ofertues.

II.5.2.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1575/2 prot., datë 14.06.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 1575/2024 prot., datë 13.06.2024. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e ankimuesit, që të skualifikohen operatorët ekonomikë “A.N.K” SHPK dhe “COBIAL” SHPK, për mospërmbushjen e kriterëve 2.3.4 dh 2.3.7 nga ana e secilit ofertues.

II.5.3. Nëpërmjet sistemimit elektronik, është dërguar nga autoriteti kontraktor vendimi “Mbi shqyrtimin e ankesës me numër Aplikimi A/2024/4211, në sistemin e ankesave elektronike”

drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, protokolluar me tonën me nr. 1575/3 prot., datë 21.06.2024 me objekt “*Informacion ardhur në sistem*”, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.5.4. Nëpërmjet shërbimit posta, është dërguar nga autoriteti kontraktor përsëri me shkresën përcjellëse me nr. 4628/2 prot., datë 21.06.2024, vendimi me nr. 4628/1 prot., datë 20.06.2024 “Mbi shqyrtimin e ankesës me numër Aplikimi A/2024/4211, në sistemin e ankesave elektronike”, drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, protokolluar me tonën me nr. 1575/4 prot., datë 24.06.2024 me objekt “*Informacion*”, ku konstatohet se e ka **refuzuar** atë.

II.5.5. Nëpërmjet shërbimit postar, bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues ka dërguar një informacion për dijeni edhe KPP, protokolluar me tonën me nr. 1736 prot., datë 27.06.2024.

II.6. Në datën 11.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/4204 dhe me nr. 1557/2024 prot, datë 12.06.2024 e operatorit ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “ARIFAJ” SHPK, për të cilin ngre pretendime mbi dokumentat të cilat kanë të bëjnë me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime si më poshtë vijon:

*“Operatori ekonomik “PE-VLA-KU” sh.p.k kerkon nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik te beje rivleresimin e pikeve pasi meritojme te vleresohemi me me shume pike nga sa na eshte vleresuar na AK gjithashtu kerkojme te na paraqesi argumentim per menyren e vleresimit dhe te perlllogaritjes se pikeve duke e bere transparente menyren e vleresimit per secilin kriter te cituar ne DST , duke qene se shoqeria PE-VLA-KU shpk eshte nje shoqeri e cila ushtron aktivitetin e saj prej 18 vitesh dhe disponon nje staf me kualifikime akademike, eksperiencë në vite pune dhe eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashem me kontratën e prokurimit mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit , per kete kemi ngarkuar ne sistem te gjithe dokumentacionin e kerkuar per stafin CV, referenca diploma licensa), kemi bindjen se eksperiencia e stafit tone te propozuar per kete projekt, eshte me e kualifikuar se vete kriteret e hartuara nga autoriteti, si dhe ne rast se do ti krahasojme me stafin e propozuar nga shoqeria Arifaj Kemi ngarkuar ne APP organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor gjithashtu sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë. Nje nga kriteret e tjera te vleresimit me pike eshte edhe Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social. Per kete kemi ngarkuar ne sistem metodologjine për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social, kemi bere Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimin e makinerive / pajisjeve ekologjike për përmirësim të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti dhe kemi Hartuar një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. Referuar metodologjise se punimeve*

dhe afatit te kryerjes se punimeve, ne kemi percaktuar se punimet per kete objekt do te kryhen per nje periudhe 12 mujore, ndryshe nga sa eshte percaktuar ne Dst, ku afati ka qene 24 muaj, dhe kemi paraqitur ne menyre te detajuar grafikun dhe metodologjin e punimeve, per te cilin duhet te merrnim piket maksimale. Per kto me siper kerkojme qe AK te na vendosi ne dispozicion menyren e Vleresimit me pike dhe menyren se si e kane perlllogaritur kete vleresim referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Per nje gare te drejte dhe te rregullt kerkojme nje ballafaqim te dokumentacionit qe operatori Ekonomik Arifaj shpk ka ngarkuar dhe ka dorezuar si fitues paraprak dhe te menyres te vleresimit te pikeve . Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit. Kemi pretendime qe vleresimi i pikeve nuk ka qene i drejte dhe per kete kerkojme transparence ne menyren se si eshte bere vleresimi i secilit prej kriterëve te permendura ne dst dhe menyra e perlllogaritjes nga AK, por gjithashtu ngreme pretendime per dokumentat e tjera te dorezuar nga operatori ekonomik i shpallur si fitues paraprak Arifaj shpk, dokumenta te cilat kane te bejne me kriteret e pergjithshme dhe te Vecanta te kualifikimit. Ne daten 11/06/2024 kemi bere nje shkrese me Nr.Prot 56 drejtuar AK e cila eshte dorezuar nepermjet postes , per te na paraqitur menyren se si eshte bere vleresimi i pikeve per PE-VLA-KU shpk ne baze te kriterëve qe vete Autoriteti Kontraktor ka vendosur ne DST dhe per kete nuk kemi marre akoma nje pergjigje , gje e cila na perforcon pretendimet qe kemi. Referuar nenit 87, te ligjit 162, “Per prokurimin publik”, i ndrydhuar, si dhe nenit 45, te vkm 285, date 19.05.2021, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, autoriteti kontraktor ka percaktuar se, oferta ekonomkisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kosos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kosos, siç janë kosot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.162, te ndryshuar, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke duke percaktuar formulën se si do te kryhet vleresimi me pike. Ne kemi bindjen, se shoqeria jone, jo vetem qe permbush kriteret e hartuara nga Autoriteti Kontraktor, por i tejkalon ato duke ofruar cilesine me te mire te punimeve bazuar edhe ne cmimin e ofertuar, dhe Autoriteti kontraktor duhet te bente nje vleresim te drejte me pike, pasi me kete Autoriteti kontraktpr ne kemi ekzekutuar disa kontrata per pune, te cilat jo vetem jane ekezekutuar me sukses por autoriteti kontraktor ka vertetuar disa here se shoqeria jone ka aftesine dhe eksperiencen e duhur per te realizuar kete kontrate objekt ankimi. Per sa mesiper, kerkojme qe autoriteti kontraktor, si dhe Komisioni i Prokurimit Publik, ne menyre qe te garantohet transparencja dhe mireperdorimi i fondeve publike, te na vleresoje me piket maksimale oferten tone te paraqitur ne kete procedure prokurimi, si dhe te vleresoje me me pak pike oferten e shoqerise “ARIFAJ” shpk, pasi kemi bindjen se ne i tejkalojme kriteret mbi bazen e te cileve eshte ber vleresimi me pike, dhe per kete duhet te ishim vleresuar me me shume pike, duke na renditur te paret. Autoriteti kontraktor ne asnje moment nuk ka bere te njohur se sa pike jane vleresuar secili kriter, per operatoret ekonomik pjesmarres, duke lene dyshime per abuzim, ne kundershtrim me frymen e ligjit per prokurimin publik. Kerkojme qe te kryhet nje hetim administrativ nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimeve Publike lidhur me vleresimin me pike per cdo kriter te ofertes se Arifaj shpk, si dhe rishikim te vleresimit me pike te kriterëve per oferten e

*paraqitur nga shoqeria jone PE-VLA-KU shpk. Nga sa me siper kerkojme qe Autoriteti Kontraktor te kryeje rivleresimin edhe njehere te Operatoreve Ekonomike Arifaj shpk dhe PE-VLA-KU shpk pasi pretendojme se PE-VLA-KU shpk meriton te vleresohet me me shume pike sesa operatori Arifaj shpk i cili eshte shpallur fitues paraprak. Pretendojme te jemi fitues te kesaj procedure prokurimi ne te cilen jemi renditur te dytet ne menyre jo te drejte, ne nje gare jo te rregullt dhe jo transparente”.*

II.6.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1557/2 prot., datë 13.06.2024 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “ARIFAJ” SHPK, për të cilin ngre pretendime mbi dokumentat të cilat kanë të bëjnë me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6.2. Nëpërmjet sistemimit elektronik, është dërguar nga autoriteti kontraktor vendimi “Mbi shqyrtimin e ankesës me numër Aplikimi A/2024/4204, në sistemin e ankesave elektronike” drejtuar operatorit ekonomik ankimues, protokolluar me tonën me nr. 1557/3 prot., datë 21.06.2024 me objekt “*Informacion ardhur në sistem*”, ku konstatohet se e ka **pranuar pjesërisht** atë.

II.6.3. Nëpërmjet shërbimit posta, është dërguar nga autoriteti kontraktor përsëri me shkresën përcjellëse me nr. 2181/9/2 prot., datë 20.06.2024, vendimi me nr. 2181/7 prot., datë 18.06.2024 “Mbi shqyrtimin e ankesës me numër Aplikimi A/2024/4204, në sistemin e ankesave elektronike”, drejtuar operatorit ekonomik ankimues, protokolluar me tonën me nr. 1557/4 prot., datë 24.06.2024 me objekt “*Informacion*”, ku konstatohet se e ka **pranuar pjesërisht** atë.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

**Arsyeton:**



III.1. Nga shqyrtimi i ankesës me nr. Elektronik A/2024/4197 dhe me nr. 1544/2024 prot, datë 11.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III.1.1. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*

*4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”*

III.1.2. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.1.3. Në datën 11.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/4197 dhe me nr. 1544/2024 prot, datë 11.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi i ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se kësaj të fundit i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

III.1.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit. Referuar arsyetimit, në kushtet kur bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, Komisioni gjykon, se ankesa me nr. Elektronik A/2024/4197 dhe me nr. 1544/2024 prot, datë 11.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

Komisioni thekson faktin se, bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes përsëri, në datën 13.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2024/4211 dhe me nr. 1575/2024 prot, datë 13.06.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, e cila është e shoqëruar me mandat pagese bankare, ku u konstatua se objekti i saj, është i njëjtë me atë të me nr. Elektronik A/2024/4197 dhe me nr. 1544/2024 prot, datë 11.06.2024.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Ulza & Pepa Group & Almo Konstruksion ” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht; → Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Puna e ngjashme e realizuar gjatë pesë viteve të fundit, e paraqitur nga operatori “Pepa Group” nuk e plotëson vlerën sipas përqindjes pjesëmarrëse në kontratën e bashkëpunimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore,
  - Aktin e kolaudimit;

**Shënim:** Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

**Shënim:** Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

**2.3.1/2** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

**2.3.1/3** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë Bashkëpunimi e lidhur më datë 07.05.2024, midis operatorit ekonomik “ULZA” SHPK, operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, dhe operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK. Sipas **Nenit 1** “Palët pjesëmarrëse në këtë Marreveshje, në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar dhe Dokumentave të Tenderit të hartuara nga Autoriteti Kontraktor - "Autoriteti Rrugor Shqiptar", deklarojnë se janë dakord të bëjnë Bashkimin e Operatoreve Ekonomike të lartpërmendur për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Rruges së Vjeter Kombinat-Ndroq-Plepa, Loti I” me fond limit 754,965,352.17 (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milion e nentëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy pike shtatëmbëdhjetë) leke pa Tvsh”.

Në **Nenin 3** të kësaj kontrate “Palet deklarojnë se kanë rënë dakord midis tyre për ndarjen e përqindjes së pjesëmarrjes për realizimin e objektit të procedurës tenderuese konform kërkesave të termave të referencës dhe legjislacionit për objekte të tilla. Ndarja e përqindjeve është si më poshtë: Shoqëria “ULZA” sh.p.k, 39 % të pjesëmarrjes dhe fitimit. Shoqëria “PEPA GROUP” sh.p.k, 23 % të pjesëmarrjes dhe fitimit. Shoqëria “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k, 38 % të pjesëmarrjes dhe fitimit”.

PEPA GROUP SHPK

Shumat me  
TVSH

Shumat Pa  
TVSH

1	Kontratë me nr. 1476 prot., datë 17.05.2019 me objekt “ <i>Sistemim, asflatim, ndricim i rruges Auto, Lagja e Vjeter Bashkia Fushe Arrez</i> ”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK & "JUNIK" SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh
	Kontratë shtesë me nr. 2817 prot., datë 11.09.2019 me objekt “ <i>Sistemim, asflatim, ndricim i rruges Auto, Lagja e Vjeter Bashkia Fushe Arrez</i> ”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK & "JUNIK" SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh
	Kontratë bashkëpunimi me nr. rep 2711 nr.kol 849, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK & "JUNIK" SHPK me datë 10.04.2019, ku operatori ekonomik “ <b>PEPA GROUP</b> ” SHPK <b>do të realizojë 95% të punimeve</b> të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “ JUNIK ” SHPK do të realizojë 5% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur		
	Prokurë e posaçme, me nr. rep 2712, nr. kol 850 datë 10.04.2019		
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 06.11.2019		
	Situacion progresiv përfundimtar		
	Akt kolaudimi me datë 06.11.2019		

	<p>Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Fushë Arrëz, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “<i>Sistemim, asflatim, ndricim i rruges Auto, Lagja e Vjeter Bashkia Fushe Arrez</i>”, data e fillimit të kontratës 20.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 04.09.2019, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK &amp; "JUNIK" SHPK , Vlerësimi: Punimet janë cilësore dhe kanë përfunduar sipas kontratës, projektit të azhornuar dhe preventivit të rishikuar, të miratuara. E përmbushur: Po</p>	XXXX	me tvsh
	Faturë tatimore nr.269 datë 28.08.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë tatimore nr.283 datë 31.07.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturëelektronike nr.1873/2021 datë 17.12.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
2	<p>Kontratë me nr. 2378prot., datë 31.07.2019 me objekt “<i>Rikonstruksion kanali, fshati Iballe, Fushe Arrez</i>”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>	XXXXXXXX	me tvsh
	<p>Amendim i Kontratës me nr. 2378prot., datë 31.07.2019 me objekt “<i>Rikonstruksion kanali, fshati Iballe, Fushe Arrez</i>”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>		
	<p>Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 14.10.2020</p>		
	Situacion punimesh përfundimtar		
	Akt kolaudimi me datë 12.10.2020		

	Procesverbali i dorëzimit përfundimtare me nr. 398 datë 13.02.2023		
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “Rikonstruksion kanali, fshati Iballe, Fushe Arrez”, data e fillimit të kontratës 31.07.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës 15.07.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK , Vlerësimi: Punimet janë cilësore dhe kanë përfunduar sipas kontratës, projektit të azhornuar dhe preventivit të rishikuar, të miratuara. E përmbushur: Po	XXXXXX	me tvsh
	Faturë tatimore nr.328 datë 03.12.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë tatimore nr.334 datë 24.12.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë tatimore nr.152 datë 31.08.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë tatimore nr.65 datë 28.09.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
3	MK Kontratë me nr. 4063/12 prot., datë 18.08.2020 me objekt “Mirembajtje, Sistemit dhe asfaltim i rrugeve Rrurale ”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh		
	Kontrat me nr. 19039/4 prot., datë 21.10.2020 me objekt “Mirembajtje, Sistemit dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 1”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 23.01.2022		

	Akt marrje përfundimtare e punimeve me datë 05.12.2023		
	Situacion përfundimtar		
	Akt kolaudimi me datë 15.01.2021		
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 1”, data e fillimit të kontratës 21.10.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 03.12.2020, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK , Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: Po	XXXXXXXX	me tvsh
	Faturë tatimore nr.71 datë 10.11.2020, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë tatimore nr.78 datë 30.11.2020, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.126/2022 datë 25.01.2022, “PEPA GROUP” SHPK		
4	MK Kontratë me nr. 4063/12 prot., datë 18.08.2020 me objekt “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale ”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh		
	Kontrat me nr. 22020/4 prot., datë 09.12.2020 me objekt “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 2”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 23.01.2022		
	Akt marrje përfundimtare e punimeve me datë 05.12.2023		
	Situacion përfundimtar		



	Akt kolaudimi me datë 12.04.2021		
	Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “ <i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale , kontrata Nr. 22020/4 prot., datë 09.12.2020</i> ”, data e fillimit të kontratës 09.12.2020, data e mbarimit të punimeve të kontratës 02.03.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK , Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: Po	XXXXXX	me tvsh
	Faturë elektronike nr.50/2021 datë 10.04.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.1/2021 datë 11.02.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
5	MK Kontratë me nr. 4063/12 prot., datë 18.08.2020 me objekt “ <i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh		
	Kontrat me nr. 4970/3 prot., datë 24.03.2021 me objekt “ <i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 3</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh
	Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 23.01.2022		
	Akt marrje përfundimtare e punimeve me datë 05.12.2023		
	Situacion përfundimtar		
	Akt kolaudimi me datë 05.07.2021		

	<p>Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “<i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale , kontrata Nr. 4970/3 prot., datë 24.03.2021</i>”, data e fillimit të kontratës 24.03.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 24.05.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK , Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: Po</p>	XXXXXX	me tvsh
	Faturë elektronike nr.87/2021 datë 05.07.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.1/2021 datë 16.04.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.2/2021 datë 24.05.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
6	<p>MK Kontratë me nr. 4063/12 prot., datë 18.08.2020 me objekt “<i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale</i>”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>		
	<p>Kontrat me nr. 16783/4 prot., datë 20.09.2021 me objekt “<i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 4</i>”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>	XXXXXX	me tvsh
	Akt marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 26.10.2023		
	Situacion përfundimtar		
	Akt kolaudimi me datë 10.05.2023		

	<p>Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “<i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale , kontrata Nr. 16783/4 prot., datë 20.09.2021</i>”, data e fillimit të kontratës 28.09.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 17.12.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK , Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: Po</p>	XXXXXX	me tvsh
	Faturë elektronike nr.1930/2021 datë 24.12.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.6805/2021 datë 20.06.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.1547/2021 datë 03.11.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
7	<p>MK Kontratë me nr. 4063/12 prot., datë 18.08.2020 me objekt “<i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale</i> ”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>		
	<p>Kontrat me nr. 6239/3 prot., datë 26.04.2022 me objekt “<i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 5</i>”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>	XXXXXX	me tvsh
	Akt marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 26.10.2023		
	Situacion përfundimtar		
	Akt kolaudimi me datë 10.05.2023		

	<p>Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “<i>Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale , kontrata Nr. 6239/3 prot., datë 26.04.2022</i>”, data e fillimit të kontratës 09.05.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 31.03.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK , Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: Po</p>	XXXXXX	me tvsh
	Faturë elektronike nr.6806/2023 datë 20.06.2023, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.6245/2023 datë 08.04.2023, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.5728/2023 datë 06.03.2023, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.2478/2022 datë 25.07.2022, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.3617/2022 datë 26.09.2022, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.4849/2022 datë 21.12.2022, “PEPA GROUP” SHPK		
8	<p>Kontratë me nr. 5937/7 prot., datë 18.07.2022 me objekt “<i>Rehabilitim i rreshqitjes segmenti rugor Qafe Mali-Fierze</i>”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK &amp; "Selami" SHPK dhe autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>	XXXXXX	me tvsh

<p>Kontratë bashkëpunimi me nr. rep 7651 nr.kol 3475, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK &amp; "Selami" SHPK me datë 04.06.2022, ku operatori ekonomik <b>“PEPA GROUP” SHPK do të realizojë 80% të punimeve</b> të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “ Selami ” SHPK do të realizojë 20% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur.</p>		
<p>Kontratë bashkëpunimi me nr. rep 2751 nr.kol 1389, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK &amp; "Selami" SHPK &amp; Nënkontraktori "Marçeli" SHPK me datë 30.06.2022, ku operatori ekonomik <b>“PEPA GROUP” SHPK do të realizojë 80% të punimeve</b> të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “ Selami ” SHPK do të realizojë 20% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur. Nënkontraktori "Marçeli" SHPK jo më shumë se 40 %</p>		
<p>Prokurë e përgjithshme, me nr. rep 4056, nr. kol 1816 datë 30.03.2022</p>		
<p>Prokurë e posaçme, me nr. rep 1340, nr. kol 329 datë 13.07.2022</p>		
<p>Situacion përfundimtar</p>		
<p>Akt kolaudimi me datë 05.06.2023</p>		

	<p>Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Krugor Shqiptar, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “<i>Rehabilitim i rreshqitjes segmenti rugor Qafe mali-Fierze</i>”, data e fillimit të kontratës 18.07.2022, data e mbarimit të punimeve të kontratës 05.06.2023, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK &amp; "Selami" SHPK. Nënkontraktori "Marçeli" SHPK , Vlerësimi: Punime të përfunduara. E përmbushur: Po</p>	<p>XXXXXX</p>	<p>me tvsh</p>
	<p>Faturë elektronike nr.3635/2022 datë 04.10.2022, “PEPA GROUP” SHPK</p>		
	<p>Faturë elektronike nr.4548/2022 datë 30.11.2022, “PEPA GROUP” SHPK</p>		
	<p>Faturë elektronike nr.4668/2022 datë 09.12.2022 “PEPA GROUP” SHPK</p>		
	<p>Faturë elektronike nr.6768/2023 datë 12.06.2023 “PEPA GROUP” SHPK</p>		
<p>9</p>	<p>Kontratë me nr. 1338 prot., datë 02.05.2019 me objekt “<i>Shtese ne pedonale + lulishte ne Qytetin e Fushe-Arrëzit</i>”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK &amp; "JUNIK" SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh</p>	<p>XXXXXX</p>	<p>me tvsh</p>

Kontratë bashkëpunimi me nr. rep 2619 nr.kol 820, midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK & "JUNIK" SHPK me datë 05.04.2019, ku operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK do të realizojë 60% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur, ndërsa operatori ekonomik “ JUNIK ” SHPK do të realizojë 40% të punimeve të cilat përbëhen sipas ndarjes së preventivit bashkëngjitur		
Prokurë e posaçme, me nr. rep 2620, nr. kol 821 datë 05.04.2019		
Certifikatë i marrje të përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 15.11.2019		
Situacion përfundimtar		
Akt kolaudimi me datë 15.11.2019		
Formular vlerësimi lëshuar nga autoriteti kontraktor Fushë Arrëz, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “ <i>Shtese ne pedonale + lulishte ne Qytetin e Fushe-Arrëzit</i> ”, data e fillimit të kontratës 16.05.2019, data e mbarimit të punimeve të kontratës ....., vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK & "JUNIK" SHPK , Vlerësimi: Punimet janë realizuar shumë mirë brenda specifikimeve dhe projektit të rishikuar. E përmbushur: Po	XXXXXX	me tvsh
Faturë tatimore nr.268 datë 28.06.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
Faturë tatimore nr.284 datë 31.07.2019, “PEPA GROUP” SHPK		
Faturë elektronike nr.1872/2021 datë 17.12.2021, “PEPA GROUP” SHPK		

10	Kontrat me sipërmarrje me datë 05.05.2021 me objekt “Ndërtim i objektit "Godinë industriale për përpunim, miksimin dhe paketimin e frutave dhe rrënjëve 1,2,3 katë me vendndodhje në Vorë”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dheInvestitori CAPITAL RESOURCES SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh	XXXXXX	me tvsh
	Leje ndërtimi me Nr. 41/19 prot., datë 09.06.2020		
	Certifikat e përkohshme në dorëzim të punimeve, me datë 30.11.2021		
	Situacion përfundimtar		
	Akt kolaudimi me datë 23.11.2021		
	Lëshim certifikat përdorimi me nr, 17/9 prot., datë 14.01.2022		
	Formular vlerësimi lëshuar nga Investitori CAPITAL RESOURCES SHPK, për operatorin ekonomik “PEPA GROUP” SHPK për objektin e kontratës “Ndërtim i objektit "Godinë industriale për përpunim, miksimin dhe paketimin e frutave dhe rrënjëve 1,2,3 katë me vendndodhje në Vorë”, data e fillimit të kontratës 05.05.2021, data e mbarimit të punimeve të kontratës 31.11.2021, vlera e realizuar e kontratës xxxxxxxx lekë me TVSh, realizuar nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK , Vlerësimi: Shumë mirë. E përmbushur: Po	XXXX	me tvsh
	Faturë elektronike nr.1403/2021 datë 09.10.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.501/2021 datë 07.08.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
	Faturë elektronike nr.494/2021 datë 07.08.2021, “PEPA GROUP” SHPK		
Faturë elektronike nr.1654/2021 datë 16.11.2021, “PEPA GROUP” SHPK			



Faturë tatimore me nr.77 datë 30.11.2020, "PEPA GROUP" SHPK		
Faturë tatimore me nr.29 datë 28.02.2020, "PEPA GROUP" SHPK		
Faturë tatimore me nr.39 datë 07.05.2021, "PEPA GROUP" SHPK		
Faturë tatimore me nr.41 datë 14.05.2021, "PEPA GROUP" SHPK		
Faturë tatimore me nr.93 datë 30.06.2021, "PEPA GROUP" SHPK		
Faturë tatimore me nr.96 datë 03.06.2021, "PEPA GROUP" SHPK		
Faturë tatimore me nr.43 datë 30.06.2021, "PEPA GROUP" SHPK		
Faturë tatimore me nr.88 datë 07.09.2021, "PEPA GROUP" SHPK		
		me tvsh
		XXX
Fondi limit pa tvsh		<b>pa tvsh</b>
		<b>XXXX</b>
754,965,352.17		
200%		
1,509,930,704.34		
23%	<b>pepa group</b>	
<b>XXXXXX</b>	<b>Shuma e punëve</b>	

III.2.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

**Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”**

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që “2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.** Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:**

c) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

**Shënim:** Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

d) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore

- Akt kolaudimi objekti;

**Shënim:** Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

**2.3.1/2** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

**2.3.1/3** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, me datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, ***Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Sa më sipër, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ULZA" SHPK & "PEPA GROUP" SHPK & "ALMO KONSTRUKSION" SHPK, konstatojmë, se referuar kontratës së bashkëpunimit me datë 07.05.2024, midis operatorit

ekonomik “ULZA” SHPK, operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, dhe operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK. Sipas **Nenit 1** “*Palët pjesëmarrëse ne kete Marreveshje, ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.162 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe te VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar dhe Dokumentave te Tenderit te hartuara nga Autoriteti Kontraktor - "Autoriteti Rrugor Shqiptar", deklarojne se jane dakort te bejne Bashkimin e Operatoreve Ekonomike te lartpermendur per proceduren e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Rrugese se Vjeter Kombinat-Ndroq-Plepa, Loti I” me fond limit 754,965,352.17 (shtateqind e pesedhete e kater milion e nenteqind e gjashtedhete e pese mije e treqind e pesedhete e dy pike shtatembedhete) leke pa Tvsh*”.

Në **Nenin 3** të kësaj kontrate “*Palet deklarojne se kane rene dakord midis tyre per ndarjen e perqindjes se pjesemarrjes per realizimin e objektit te procedures tenderuese konform kerkesave te termave te references dhe legjislacionit per objekte te tilla. Ndarja e perqindjeve eshte si me poshte: Shoqëria “ULZA” sh.p.k, 39 % te pjesëmarrjes dhe fitimit. Shoqëria “PEPA GROUP” sh.p.k, 23 % te pjesëmarrjes dhe fitimit. Shoqëria “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k, 38 % te pjesëmarrjes dhe fitimit*”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky bashkim operatorësh ekonomik i krijuar me kontratën e bashkëpunimit të datës 07.05.2024, ka paraqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi, ku përfaqësues i këtij bashkimi rezulton të jetë shoqëria “ULZA” SHPK. Për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur dokumentacionin e cituar në pikën III.2.2.

Nga krahasimi i kontratave të dorëzuara nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara nga secili anëtar i këtij bashkimi operatorësh ekonomikë, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionit të specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomike ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (*ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjecar nga data e njoftimit të kontratës*), komponenti vlerë (*lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra, a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës apo b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet* si dhe komponentit natyrë e ngjashme (*i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre*).

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, me një vlerë jo më të madhe se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesë vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. KPP verifikoi dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga anëtari i BOE, operatori ekonomik **“PEPA GROUP”** SHPK për plotësimin e kushtit të dytë *“b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”*.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur që nga objekti i tyre, vërtetimi i realizimit (si dokument i përcaktuar në kriter për vërtetueshmërinë e punëve të ngjashme), përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha kontratat e dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë **“PEPA GROUP”** SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1/b të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim këto kontrata të ngarkuara në PDF në sistemin e prokurimit elektronik:

1-. Kontratë me nr. 1476 prot., datë 17.05.2019 me objekt *“Sistemim, asflatim, ndricim i rruges Auto, Lagja e Vjeter Bashkia Fushe Arrez”*, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë **“PEPA GROUP”** SHPK & **“JUNIK”** SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi,

certifikate e marrjes në dorëzim, me prokurë të posaçme, me kontratë bashkëpunimi midis boe, dhe fatura tatimore.

2-. Kontrat me nr. 19039/4 prot., datë 21.10.2020 me objekt “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 1”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

3-. Kontrat me nr. 22020/4 prot., datë 09.12.2020 me objekt “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 2”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

4-. Kontrat me nr. 4970/3 prot., datë 24.03.2021 me objekt “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 3”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

5-. Kontrat me nr. 16783/4 prot., datë 20.09.2021 me objekt “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 4”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

6-. Kontrat me nr. 6239/3 prot., datë 26.04.2022 me objekt “Mirembajtje, Sistemim dhe asfaltim i rrugeve Rrurale nr. 5”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Lezhë, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim dhe fatura tatimore.

7-. Kontratë me nr. 5937/7 prot., datë 18.07.2022 me objekt “Rehabilitim i rreshqitjes segmenti rugor Qafe Mali-Fierze”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK & "Selami" SHPK dhe autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim, me prokurë të posaçme, me kontratë bashkëpunimi midis boe, dhe fatura tatimore.

8-. Kontratë me nr. 1338 prot., datë 02.05.2019 me objekt “Shtese ne pedonale + lulishte ne Qytetin e Fushe-Arrëzit ”, lidhur midis bashkimit të operatorëve ekonomikë “PEPA GROUP” SHPK & "JUNIK" SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh, shoqëruar me formular vlerësimi, situacion, akt kolaudimi, certifikate e marrjes në dorëzim, me prokurë të posaçme, me kontratë bashkëpunimi midis boe, dhe fatura tatimore.

Komisioni Prokurimit Publik do të marrë në shqyrtim në themel kontratat e sipërcituara, pasi këto kontrata i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brënda afatit pesë vjecar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Komisioni Prokurimit Publik, pasi veçoi kontratat e sipërcituara, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren se, nga përlllogaritja e kontratave, situacionet dhe faturat e paraqitura nga anëtarë i bashkimit operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK, rezulton se janë në vlerën

XXXXXX lekë me TVSH ose XXXX lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet *b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*, dhe referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK 23 % ose XXXXX lekë pa TVSH. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratat e ngjashme të marrë në shqyrtim rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ” PEPA GROUP” SHPK, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në secilën prej kontratave të paraqitura, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXX lekë me TVSH ose XXXX lekë pa TVSH, duke mos e kaluar vlerën prej XXXXX lekë pa TVSH që duhet të plotësojë ky operator në varësi të përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, duke e përmbushur kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit *b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*. Rrjedhimisht ky kriter nuk do të konsiderohet i përmbushur nga anëtari i bashkimit operatori ekonomik ” PEPA GROUP” SHPK. Sa më lart, nga verifikimi i punëve të realizuara dhe dokumentacionit shoqëruar të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik ankimes ka kryer punime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nga përlllogaritja e vlerës së punëve të ngjashme të paraqitura nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “PEPA GROUP” SHPK, duke e përlllogaritur sipas përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në kontratën e paraqitur, vlen të theksohet, se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik XXXX lekë pa TVSH, nuk arrin të kalojë vlerën prej XXXX lekë pa TVSH, të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Nga verifikimi i zërave dhe volumeve të ngjashme të preventivit të kontratave të paraqitura nga ankimesi si eksperiencia të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, tipologjisë, emërimit/përshkrimit, me zërat e preventivit të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ankimes ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por nuk ka arritur të dëshmojë këtë realizim duke arritur në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi zërat e konsideruar të ngjashëm përmbushin vlerën prej XXXX lekë pa TVSH, dhe jo sipas kërkesës së autoritetit kontraktor të përmbushi vlerën prej XXXXX lekë pa TVSH, në bazë të përqindjes së pjesëmarrjes së këtij të fundit në kontratën e paraqitur.



Referuar gjykimit të mësipërm, KPP, kërkon të sqarojë, se në lidhje me:

1.- Kontratë me nr. 2378prot., datë 31.07.2019 me objekt “Rikonstruksion kanali, fshati Iballe, Fushe Arrez”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Fushë Arrëz, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh.

2.- Kontrat me sipërmarrje me datë 05.05.2021 me objekt “Ndërtim i objektit "Godinë industriale për përpunim, miksimin dhe paketimin e frutave dhe rrënjëve 1,2,3 katë me vendndodhje në Vorë”, lidhur midis operatorit ekonomik “PEPA GROUP” SHPK dheInvestitori CAPITAL RESOURCES SHPK, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh.

Në lidhje me këto dy kontrata, Komisioni sqaron se, këto nuk janë me natyrë të ngjashme me objektin që prokurohet që është rikonstruksion rruge. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara nga operatori ekonomik “PEPA GROUP” sh.p.k., me preventivin, specifikimet teknike dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmime të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së projektit objekt të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar preventivit të punimeve, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, në strukturën e punimeve autoriteti kontraktor ka parashikuar, me sasi dhe volume respektive për realizimin e kontratës. Në rastin konkret, KPP gjykon, se nuk kemi të bëjmë me realizimin e punimeve standarde ndërtimore civile, por me një projekt specifik, jo vetëm në objektin e tij, por edhe natyrën e punimeve të kërkuara.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, **si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohe, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kerkimit të dëshmime për përvojën e mëparshme, me synim **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.** Pra e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike ligjvënësi në nenin 39 pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter mund të të përmbushet me dorëzimin e një kontrate të ngjashme me një vlerë jo më të madhe se 50 % të vlerës së*

përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar edhe me punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë sëbashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës së prokurimit. Gjithashtu në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesëvjeçare sikundër parashikohet edhe në Vendim të Këshillit të Ministrave.

Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të kontratave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik ankimes, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar të sipërcituar se dëshmon, se ka kryer punime ndërtimore civile si kanale vaditëse, kanalizime, mbjellje bari dhe fidanë dekorativ, por në asnjë rast nuk dëshmon me këto dy kontrata të sipërcituara se disponon eksperiencën e nevojshme për rikonstrukcion rruge. Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi kërkojnë ekspertizë dhe eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimesi me anë të kontratave të sipërcituara, pasi dhe vetë metodologjia e ndërtimit të saj është e ndryshme, referuar specifikimeve teknike dhe relacionin teknik, ku konstatohet, se kemi të bëjmë me rikonstrukcion rruge.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë pune publike, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit ( ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie**. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimes janë punë publike/private (investitor) me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka patur punime të ngjashme në natyrë dhe metodologji me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt-prokurimi. KPP konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre si dhe përshkrimi i punimeve në situacion apo faturë tatimore si pjesë përbërëse e kontratave, rezulton se asnjëra prej dy kontratave të sipërcituara nuk mund të konsiderohet e ngjashme me objektin e prokurimit, konkretisht kontrata me objekt “*Rikonstrukcion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti I*”. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “PEPA GROUP” SHPK me dokumentacionin e paraqitur pra dy kontratat e sipërcituara, nuk provon se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura përmbajnë objekt dhe zëra të cilat nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të projektit ka rikonstrukcion rruge.

III.2.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi

por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues “PEPA GROUP” SHPK nuk arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.1/b të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “, operatori “Almo Konstruksion” nuk përmbush kriterin 2.3.4 “Stafin mbështetës” pasi, staf mbështetës i vetdeklaruar në shtojcën 8, është i angazhuar në një kontratë në proces pranë Autoritetit Kontraktor, kjo në kundërshtim me pikën 2.3.4 ku thuhet; “Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 8 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

*(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*

#### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

---

---

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

## **B: DEKLARATA**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
- b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### **C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”**

##### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:



- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik\_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

### Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

**“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<b>Punonjës</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. ._____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë _____sonë, në rolin e _____, 2. ._____,me

	profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, 3. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, <b>Makineri e mjete</b> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

### C: DEKLARATË

**“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshte:

<b>Në pronësi</b>				
<b>Lloji i Mjetit</b>	<b>Targa</b>	<b>Nr. Lejes qarkullimit</b>	<b>Nr. Shasisë</b>	<b>Të tjera</b>
1				
2				
3				
4				
5				

<b>Me qira</b>					
<b>Lloji i Mjetit</b>	<b>Targa e mjetit</b>	<b>Nr. Lejes qarkullimit të mjetit</b>	<b>Nr. Shasisë së mjetit</b>	<b>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)</b>
1					
2					
3					
4					
5					
6					

<b>Kontratë furnizimi</b>			
<b>Materiali/pro dukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit</b>	<b>Nr. Kont së furnizimit (noterisë)</b>	<b>Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)</b>	<b>Të tjera</b>
1.			
2			
3			
4			

**D: Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të tjera**

**Deklarata**  
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:  
Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:  
Z. \_\_\_\_\_, me profesion \_\_\_\_\_, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e \_\_\_\_\_,  
etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

**Emri, Mbiemri** \_\_\_\_\_  
**Firma** \_\_\_\_\_  
**Vula** \_\_\_\_\_  
**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

III.3.2. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” “*Kapaciteti Teknik*”, pika 22.3.4; është parashikuar kriteri kualifikues, si më poshtë:

**2.3.4 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:**

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e Transport)**

- **1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshajder**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

*Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- ❖ Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

III.3.3. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “ALMO KONSTRUKSION” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:  
-Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit nga “ALMO KONSTRUKSION” SHPK;

#### ***D: Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të tjera***

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:*

*Mjetet/pajisjet/makinieritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut të punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:*

- 1. Z. E. B., me profesion Inxhinier ndertimi (Drejtues Teknik), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinierit të ndertimit (drejtuesit teknik)*
- 2. Z. N. H., me profesion inxhinieri Topograf (Drejtues Teknik), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinier topograf (drejtuesit teknik),*
- 3. Z. D. P., me profesion inxhinier Gjeolog (Drejtues Teknik), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinier Gjeolog (drejtuesit teknik),*
- 4. Z. E. B., me profesion inxhinier Mekanik (Drejtues Teknik), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinier Mekanik (Drejtues Teknik).*
- 5. Z. E. A., me profesion inxhinier Mjedisi (Drejtues Teknik), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinier të Mjedisit (drejtuesit teknik),*
- 6. Z. R. L., me profesion inxhinier hidroteknik (Drejtues Teknik), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e rolin e inxhinierit hidroteknik (drejtuesit teknik),*
- 7. Z. E. M., me profesion inxhinier elektrik (Drejtues Teknik), i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e rolin e inxhinierit elektrik (drejtuesit teknik),*
- 8. Z.Sh. B., me profesion Inxhinier ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinierit të ndertimit***

9. Z. R. A., me profesion inxhinier topograf, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e inxhinierit inxhinierit Elektrik (drejtuesit teknik),

10. Z.R. K., i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Ekspert per Ndhimen e Pare dhe Nderhyrjen ndaj emergjencave. topograf,

11. Z. A. B., i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune etj.,i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

III.3.4. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.3.6. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, rezulton se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues për plotësimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.4 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit duhet të deklarojë që *Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e Transport)
- 1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Dhe sipas formatit të Shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” se D: *Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të tjera.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK ka deklaruar në ofertën e tij, nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, se ka të punësuar për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 përkatësisht 1 (një) Inxhinier Ndërtimi stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), konkretisht Z.Sh. B., me profesion Inxhinier ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, në rolin e Inxhinierit të ndërtimit.

III.3.7. Referuar sa më sipër KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriteret kualifikuese të përcaktuara përkatësisht në pikën 2.3.4, të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit ka kërkuar që operatori ekonomik të deklarojë nëpërmjet plotësimit dhe dorëzimit të Shtojcës 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” se disponon stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), kërkuar në këtë kriter kualifikues dhe të trajtuar në pikën III.3.2 të këtij vendimi, gjë të cilën operatori ekonomik ankimes e ka përmbushur nëpërmjetë deklarimit në Shtojcës 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të datës 08.05.2024 dhe të dorëzimit të kësaj shtojce në dokumentacionin e ofertës. Autoriteti kontraktor në kriteret kualifikuese të përcaktuara përkatësisht në pikën 2.3.4; të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit ka kërkuar që operatori ekonomik të deklarojë se stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet

të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria ankimuese “ALMO KONSTRUKSION” SHPK dhe konkretisht i Shtojcës 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të datës 08.05.2024 për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar përkatësisht në pikën 2.3.4c; lidhur me disponimin e stafit mbështetës ku është kërkuar si në vijim: “1 (një) *Inxhinier Ndërtimi*; 1 (një) *Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë e Transport)*; 1 (një) *Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshajder*; 1 (një) *Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik*; 1 (një) *Inxhinier Mekanik*; 1 (një) *Inxhinier Mjedisi*, 1 (një) *Inxhinier Hidroteknik dhe 1 (një) Inxhinier Elektrik*”, KPP gjykon se ka plotësuar kriterin kualifikues të sipërpërmendur, duke deklaruar nëpërmjet Formularit përmbledhës së Vetdëklarimit D: *Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata të tjera*, se disponon stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), të kërkuar. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka përcaktuar se kriterin kualifikues të përcaktuar përkatësisht në pikën 2.3.4 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit konsiderohen të përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” i dokumentave të tenderit si dhe ka kërkuar që operatori ekonomik të deklarojë se stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar dokumentacionin e stafit mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), që nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese, të deklaruara nga ana e operatorit ekonomik ankimues, por meqënëse shoqëria ankimuese është përfituese e një kontrate tjetër po me këtë autoritet kontraktor, komisioni i vlerësimit të ofertave ka verifikuar deklaratimet e bëra nga ofertuesi në Shtojcën 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të datës 08.05.2024 me deklarinimin e mëparshme të shoqërisë datë 30.10.2023 të shoqërisë “ALMO KONSTRUKSION” SHPK në fazën e ofertimit dhe për të cilën është shpallur fituese, duke lidhur me autoritetin kontraktor ARRSH konkretisht kontratën me nr---, datë---=-----, me *objekt* : “*Eliminimi i pikave të zeza (Black Spots)* nga ku rezulton se: stafi i vetdeklaruar ku përfshihet edhe Z. Sh. B., ing ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë në rolin e inxhinierit të ndërtimit, i deklaruar në këtë procedurë, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. Pra sipas komisioni i vlerësimit të ofertave shoqëria “ALMO KONSTRUKSION” SHPK ka vetdeklaruar se ing. Sh. B. do të jetë i angazhuar vetëm në kontratën me *objekt* “*Eliminimi i pikave të zeza (Black Spots)*”. Kjo kontratë vijon të jetë në zbatim nga Autoriteti Kontraktor dhe Z. Sh. B. është pjesë e stafit për zbatimin e plotë të kësaj kontrate.

Nga shqyrtimi i Shtojcës 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të datës 08.05.2024, të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, Komisioni konstaton se pika D e kesaj shtojce është plotësuar duke bërë deklaratimet e kërkuara, ndërsa lidhur me arsyen e skualifikimit të datës 29.05.2024, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me argumentin se disa nga pjestarët e stafit teknik të deklaruar në Shtojcës 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I*



*VETËDEKLARIMIT*” të datës 08.05.2024, janë të angazhuara në kontratën nr. me nr---, datë---=---, me objekt: “Eliminimi i pikave të zeza (Black Spots), e cila është në fazë zbatimi nuk qëndron, pasi në pikën D të Shtojcës 8 është parashikuar që të deklarohet se stafi teknik i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti, pra vetëm në rastet kur stafi teknik i deklaruar për realizimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi dhe i angazhuar në kontratë me nr---, datë---=-----, me objekt: “Eliminimi i pikave të zeza (Black Spots), bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, duke e plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4. të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, pasi në njoftimin e skualifikimit të datës 29.05.2024, autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar se angazhimi i një pjesë të stafit teknik të deklaruar në Shtojcën 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të datës 30.10.2023 dhe i angazhuar njëkohësisht në kontratën nr---, date---=-----, me objekt : *Eliminimi i pikave të zeza (Black Spots)*, bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e kapacitetit teknik, por në tejkalim të tij. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALMO KONSTRUKSION” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PE-VLA-KU” SHPK, “*mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga ky i fundit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Nëpërmjet sistemimit elektronik, është dërguar nga autoriteti kontraktor vendimi “Mbi shqyrtimin e ankesës me numër Aplikimi A/2024/4204, në sistemin e ankesave elektronike”

drejtuar operatorit ekonomik ankimues, protokolluar me tonën me nr. 1557/3 prot., datë 21.06.2024 me objekt “*Informacion ardhur në sistem*”, ku konstatohet se e ka **pranuar pjesërisht** atë.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

2. *Vlerësimi për grafikun e punimeve është bazuar në afatin e realizimit të punimeve (të paraqitur në grafikët e punimeve), si dhe faktorë favorizues/paisje inovative/ metodologji punimesh. ( Total 15 pikë) nga KVO është bërë vlerësimi si më poshtë :*

*Nënkriteri a): – Grafiku i punimeve të Kontratës (10 pikë) është llogaritur sipas formulës së dhënë në DST dhe afateve të përcaktuara nga secili operator, konkretisht:*

*-Nga BOE “ARIFAJ & EUROCOS” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 20 muaj, i cili është vlerësuar me 5.65 pikë.*

*-Nga BOE “ELMAZAJ & NDERTIMI & NDREGJONI” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 22 muaj, i cili është vlerësuar me 5.14 pikë.*

*-Nga BOE “Alb Tiefbau & Mela” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 16 muaj, i cili është vlerësuar me 7.06 pikë.*

*-Nga OE “Pevlaku” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 24 muaj, i cili është vlerësuar me 4.71 pikë.*

*-Nga OE “ANK” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 20 muaj, i cili është vlerësuar me 5.65 pikë.*

*-Nga OE “COBIAL” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 24 muaj, i cili është vlerësuar me 4.71 pikë.*

*\*\*Komisioni i shqyrtimit të ankesave konstaton se vlerësimi i nën kriterit të dytë “Grafiku i punimeve”, sipas llogaritjes me formulë ka një pasaktësi. Pikët për grafikun të llogaritura nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave janë si më poshtë:*

*- Nga BOE “ARIFAJ & EUROCOS” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 20 muaj. Sipas llogaritjeve me formulë vlerësohet me 8 pikë.*

*-Nga BOE “ELMAZAJ & NDERTIMI & NDREGJONI” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 22 muaj. Sipas llogaritjeve me formulë vlerësohet me 7.27 pikë.*

*-Nga BOE “Alb Tiefbau & Mela” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 16 muaj. Sipas llogaritjeve me formulë vlerësohet me 10 pikë.*

*-Nga OE “Pevlaku” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 24 muaj. Sipas llogaritjeve me formulë vlerësohet me 6.67 pikë.*

*-Nga OE “ANK” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 20 muaj. Sipas llogaritjeve me formulë vlerësohet me 8 pikë.*

*-Nga OE “COBIAL” shpk afati i paraqitur në grafikun e punimeve është 24 muaj. Sipas llogaritjeve me formulë vlerësohet me 6.67 pikë.*

*Lidhur me pretendimin nga operatori ekonomik PE-VLA-KU se punimet për këtë objekt do të kryhen për një periudhë 12 mujore komisioni i shqyrtimit të ankesave verifikoi metodologjinë e punimeve, grafikun, dhe konstaton se, në faqen e parë të metodologjisë jeni shprehur: kohëzgjatja 12 muaj, por konstatojmë se në grafikun e punimeve të paraqitur nga ana juaj kohëzgjatja është 24 muaj e detajuar sipas zërave respektive. ( bashkëlidhur grafiku). Gjithashtu në faqen 5 të metodologjisë, keni përcaktuar kohëzgjatjen 24 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës me autoritetin kontraktor. ( bashkëlidhur metodologjia e paraqitur nga ju faqe 1 - 5).*

5. Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit (10 pikë). Pikët për periudhën e garancisë dhe mirëmbajtjes së objektit janë llogaritur sipas formulës së dhënë në DST. Nga KVO është vlerësuar si më poshtë:

-Nga BOE “ARIFAJ & EUROCOS” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 24 muaj, i cili është vlerësuar me 6.49 pikë.

-Nga BOE “ELMAZAJ & NDERTIMI & NDREGJONI” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 26 muaj, i cili është vlerësuar me 7.03 pikë.

-Nga OE “ALBTIEFBAU & MELA” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 31 muaj i cili është vlerësuar me 8.38 pikë.

-Nga OE “PEVLAKU” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 36 muaj, i cili është vlerësuar me 9.73 pikë.

-Nga OE “ANK” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 36 muaj, i cili është vlerësuar me 9.73 pikë.

-Nga OE “COBIAL” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 24 muaj, i cili është vlerësuar me 6.49 pikë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se vlerësimi i nën kriterit të 5/a,b Garancia dhe mirëmbajtja e punimeve, sipas llogaritjes me formulë ka një pasaktësi. Pikët për grafikun të llogaritura nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave janë si më poshtë:

-Nga BOE “ARIFAJ & EUROCOS” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 24 muaj i cili është vlerësuar me 6.67 pikë.

-Nga BOE “ELMAZAJ & NDERTIMI & NDREGJONI” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 26 muaj, i cili është vlerësuar me 7.22 pikë.

-Nga OE “ALBTIEFBAU & MELA” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 31 muaj, i cili është vlerësuar me 8.61 pikë.

-Nga OE “PEVLAKU” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 36 muaj, i cili është vlerësuar me 10 pikë.

-Nga OE “ANK” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 36 muaj, i cili është vlerësuar me 10 pikë.

-Nga OE “COBIAL” shpk afati i paraqitur për periudhën e garancisë së punimeve dhe mirëmbajtjes është 24 muaj, i cili është vlerësuar me 6.67pikë.

\*\*Lidhur me kriterin 5 Garancia dhe mirëmbajtja, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se operatori ekonomik PE-VLA-KU ka të drejtë pasi në këtë kriter ai vlerësohet me pikët maksimale.

III.4.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.4.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.4.4. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar dhe do të vazhdojë shqyrtimin për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PE-VLA-KU” SHPK me argumentin se: “Ne besojmë se propozimi ynë teknik është nënvlerësuar padrejtësisht dhe kërkojmë një rivlerësim të drejtë dhe të paanshëm. Jemi të bindur se propozimi ynë përmbush plotësisht kriteret e përcaktuara dhe meritojmë pikët maksimale”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, kreu I “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 21 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, parashikon:

**Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

*Po* - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

*Pk1/Pk2/Pk3/...* - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

*Pk1* \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

*Vmink1* Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

*Pmaxk1* Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

*Ok1* Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

III.5.2. Në dokumentat e tenderit, Seksioni 4.4, “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

#### **4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

##### **A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

**Çmimi**  pikët 50

**Propozimi Teknik**  pikët 50

**Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

*Pe* - Pikët për Propozimin Ekonomik

*Çu* - Çmimi më i Ulët i Ofruar

*Ç* - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{Çu}{Ç}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

#### **Kriteret e Vlerësimit**

#### **Pikët**

(i) **Përvoja per Punë të Ngjashme të Konsulentit** [0-10]

#### **Nënkriteret**

**i/a Përvoja për punë të ngjashme** 40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

**i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%**

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(ii) **Metodologjia e Propozuar** [20-30]

#### **Nënkriteret**

<i>ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia</i>	<i>[20-30%]</i>
<i>ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit</i>	<i>[30-40%]</i>
<i>ii.c. Organizimi i Stafit</i>	<i>[20-30%]</i>

**ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:** Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:** Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlydhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

**ii/c. Organizimi dhe Stafit:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]
- b- Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

**(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]**

*Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.*

***Vlerësimi përfundimtar***

*Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:*

***Pesha për Propozimin Teknik:  $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$***

***Pesha për Propozimin Ekonomik:  $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$***

*Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:*

***Oferta më e mirë =  $X + Y$***

*Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.*

III.5.3. Në përmbushje të kriterëve vleresuese për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, operatori ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

-Kontratë pune me nr. Rep 610, Nr. Kol, 246, me datë 02.02.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Z, S. Q, në pozicionin e drejtuesit teknik, ing ndërtimi, me diplomë nr. 2399, Licensë Z.3815/1, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 344, Nr. Kol, 163, me datë 20.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Z, D. L., në pozicionin e drejtuesit teknik, ing gjeodet me diplomë nr. M-671, Licensë T.1269/1, Cv, librezë pune, Certifikatë “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurnë dhe shëndetin në punë për riskun e lartë, dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 318, Nr. Kol, 144, me datë 20.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Z, Sh. L., në pozicionin e drejtuesit teknik, ing gjeolog, me diplomë nr. MP-172, , certifikatë profesionale GIS, të gjuhës angleze, certifikat mbi procesin e menaxhimit të sigurt, dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 341, Nr. Kol, 160, me datë 20.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Z, T.K., në pozicionin e drejtuesit teknik, ing mekanik, me diplomë nr. 1240, Licensë M.1238, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 339, Nr. Kol, 158, me datë 20.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Zj. L. A., në pozicionin e drejtuesit teknik, ing mjedisi, me diplomë nr. M-594, certifikat trajnimi për “Përgjegjës për mbojjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis”, “Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, “Përgjegjës për sigurnë dhe mbrotjen e shëndetit në punë”, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 3438, Nr. Kol, 1403, me datë 13.06.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Znj. D. Ç, në pozicionin e drejtuesit teknik, ing hidroteknike, me diplomë nr. MP-324, Licensë K.3277, certifikat kualifikimi për menaxher projekti, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 5985, Nr. Kol, 4167, me datë 02.07.2021 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Znj. E. M, në pozicionin e ing elektrik, me diplomë nr. M-33 dhe numër amze Poielb 010023., Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 3915, Nr. Kol, 1580, me datë 18.07.2022 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Znj. E. M, në pozicionin e ing nërtimit, me diplomë nr. 4216, datë 12.12.2012, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 343, Nr. Kol, 162 me datë 20.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Z.O.V., në pozicionin e drejtuesit teknik, ing nërtimi, me diplomë nr. 3561, Licensë K.1332/1, certifikat kualifikimi “Persomim e ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë për riskun e lartë”, “certifikatë kalifikimi pasuniversitar Vlerësimi i pasurive të paluajtshme” nr. 164, datë 30.06.2012, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 342, Nr. Kol, 161, me datë 20.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Z. J. A, në pozicionin e ing gjeodet, me diplomë nr. MP-736, certifikat kualifikimi “ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjncave”, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 448, Nr. Kol, 192, me datë 26.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe M.Sh., në pozicionin e drejtuesit teknik, ing mekanik, me diplomë nr. 1587-B, Licensë MZ.0707, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 3250, Nr. Kol, 2362, me datë 26.03.2024 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe H.A., në pozicionin e Mjekut, me diplomë nr. 4904/B, Licensë Nr.204, Cv dhe librezë pune;

-Kontratë pune me nr. Rep 344, Nr. Kol, 163, me datë 20.01.2023 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dhe Z.D. L, në pozicionin e drejtuesit teknik, ing gjeodet, me diplomë nr. M-671, Licensë T.1269/1, certifikat kualifikimi “Persomim e ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë për riskun e lartë”, Cv, librezë pune dhe referenca pune;

-Kontratë pune, me datë 01.03.2022 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dega në Kosovë, dhe Z.T. M, në pozicionin e ing gjeolog, me diplomë nr. B-3696, Cv, dhe referenca pune;

-Kontratë pune, me datë 01.04.2019 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dega në Kosovë, dhe Z.R. F, në pozicionin e ing mjedisi dhe Përgjegjës për sigurnë në punë dhe emergjncave, me diplomë me titulli master i shkencave teknike nga Rep. Ks, dilpomë me titull master i menxhimit të emergjncave nga Rep. Ks, Certifikatë “Master i menaxhimit të emergjncave, mbrotja në punë”, certifikat Organimimi dhe menaxhimi i kantierit të ndërtimit, Certifikatë siguria në kantierin e ndërtimit”, Certifikatë Fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, Cv, dhe referenca pune;

-Kontratë pune, me datë 01.03.2019 midis palëve Shoqërisë “PE-VLA-KU” SHPK dega në Kosovë, dhe Z.E. K, në pozicionin e ing hidroteknikë, me diplomë nga Rep. Ks, Certifikatë “siguria dhe shëndeti në vendim e punës”, Cv, dhe referenca pune;

III.5.4. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*



Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.5. Në nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar

*nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.*

*5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

*Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.*

III.5.6. Në nenin 88 “Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

*1. Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:*

*a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:*

*i. kostot që lidhen me blerjen;*

*ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;*

*iii. kostot e mirëmbajtjes;*

*iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.*

*b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik.*

*2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.*

*Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:*

*a) bazohet mbi kriteret objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese.*

*b) nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;*

*c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;*

*ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.*

III.5.7. Neni 47 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*

*2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e*

*kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

*2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:*

*a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;*

*b) elementet fiskale;*

*c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës .*

*3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.*

*4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:*

*a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose*

*b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose*

*c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.*

*5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:*

*a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose*

*b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.*

*6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.*

*7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.*

*8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehur në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.*

III.5.8. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale. Referuar bazës ligjore të sipërcituar ku parashikohet se vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore, të tilla si Çmimi (50 pikë), Grafiku i punimeve dhe metodologjia (15 pikë), Stafi/Organizimi i kompanisë (15 pikë), Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social (10 pikë) dhe Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit (10 pikë), sipas dokumentave standarde të tenderit, të hartuara nga autoriteti kontraktor. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

<b>Çmimi</b> □	<b>pikët 50</b>
<b>Grafiku i punimeve dhe metodologjia</b> □□	<b>pikët 15</b>
<b>Stafi / Organizimi i Kompanisë</b> □ □	<b>pikët 15</b>
<b>Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social</b> □□	<b>pikët 10</b>
<b>Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit</b> □□	<b>pikët 10</b>

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë të *Ofertës ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto*, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë

duhet ti nënshtrohen një analizë të thellë dhe të detajuar, mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar.

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes “PE-VLA-KU” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi si, konstaton se në lidhje me **komponentin e parë konkretisht çmimi**, kanë paraqitur formularin e ofertës në vlerat respektive:

- "PE-VLA-KU " SHPK 664,401,306.98 lekë pa Tvsh
- BOE “ARIFAJ” SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K. Dega Ne Shqiperi 567,751,800 lekë pa Tvsh

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

### **Çmimi [50 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\text{mink1}} \times P_{\text{maxk1}} / O_{k1}$$

$P_{k1}$  Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\text{mink1}}$  Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\text{maxk1}}$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

$$P_{k1} = 50 \times 567,751,800 / 664,401,306.98 = 42.73 \text{ pikë}$$

Referuar formulës së përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kemi:

	Ofertuesit	Oferta ekonomike	<b>Pikët totale</b>
1	PE-VLA-KU	664,401,306.98	<b>42.73</b>
2	BOE “ARIFAJ” SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K. Dega Ne Shqiperi	567,751,800	<b>50</b>

Nga përllogaritja e pikëve për secilin ofertues të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, në bazë të formulës së përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, është përcaktuara sipas tabelës së mësipërme dhe janë të njëjta me pikët e përllogaritura nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me komponentin “çmim”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, formulën përkatëse të përllogaritjes së pikëve, e cila i është bërë e njohur të gjithë operatorëve ekonomikë. Sa më sipër, referuar formulës, rezulton se autoriteti kontraktor ka përllogaritur drejtë dhe bazuar në formulën e detajuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, pikët në lidhje me komponentin “çmim”.

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

### **III.5.9. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

\*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]

\*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë. Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes mbi vlerësimin me pikë për stafin kryesor të propozuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, atë kryesor dhe mbështetës, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara duke u shoqëruar me licencat profesionale në zbatim në ndërtim, CV-të, kontratat e punës, diplomat, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen qartë profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre.

I. *Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "PE-VLA-KU" SHPK dhe boe "ARIFAJ" SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K., si edhe vendim të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i kanë plotësuar kushtet e veçanta dhe janë vlerësuar të gjithë me 1 pikë.

II. *Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë];*

III. *Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]*

IV. *Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]*

Për të tre nënkriteret e sipërcituara, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "PE-VLA-KU" SHPK dhe boe "ARIFAJ" SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K., si edhe vendim të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se për boe "ARIFAJ" SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K., nuk ka paraqitur asnjë dokument provues mbi stafin se disponon

kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin. Në këto kushte, autoriteti kontraktor e ka vlerësuar me 0 pikë. Ndërsa, për operatorin ekonomik ankimes "PE-VLA-KU" SHPK, Komisioni konstaton se ky ka dorëzuar për personelin kryesor, drejtues teknikë në licensën e shoqërisë dhe për stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licensën e shoqërisë), dokumentacionin e cituar në pikën III.5.3. ku për secilin të punësuar ka dorëzuar kontratë pune individuale, diplomë, licensë në zbatim (për personelin kryesor drejtues), Cv, librez pune, kualifikime akademike dhe referenca pune. Pra, stafi kryesor dhe ai mbështetës së operatorit ekonomik ankimes "PE-VLA-KU" SHPK, me dokumentacionin e paraqitur dëshmojnë se kanë kualifikime akademike, eksperiencë pune në vite si dhe eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimes "PE-VLA-KU" SHPK ka paraqitur dokumentacionin e kërkuara sipas nënkriterit të kërkuara duke dëshmuar përmbushjen e tij. Lidhur me pretendimin e OE ankimes mbi vlerësimin me pikë për stafin kryesor të propozuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, atë kryesor dhe mbështetës, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara duke u shoqëruar me licencat profesionale në projektim, CV-të, kontratat e punës, diplomat, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen qartë profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nisur nga dokumentacioni i OE ankimes, ku evidentohet se plotësohen dhe tejkalohen dukshëm kërkesat e autoritetit kontraktor i cili në rastin konkret nuk ka vendosur kufizime lidhur me eksperiencën e punonjësve, si edhe nga verifikimi i licencave, cv, diplomave, kualifikimeve etj., autoriteti kontraktor duhej të pasqyronte vlerësimin me pikë jo minimalisht për këtë operator ekonomik në lidhje me stafin e tij. Pretendimi i ankimesit për vlerësimin maksimale, është i bazuar për sa kohë që gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nuk është evidentuar asnjë mangësi apo parregullsi, të cilat do të ndikonin në uljen e vlerësimin me pikë për këtë kriter. Një gjykim tërësisht subjektiv dhe të paarsyeshëm ka mbajtur edhe KSHA gjatë shqyrtimit të ankesës së OE ankimes duke argumentuar se *Vlerësimi është kryer referuar mesatare të përgjithshme të punonjësve të secilit operator*. KPP gjykon se një gjykim i tillë sipërfaqësor dëshmon se KSHA nuk ka analizuar në thellësi përvojat profesionale të secilit punonjës pjesë e stafit të OE ankimes të cilët rezultojnë të gjithë brenda profilit të kërkuar dhe me eksperiencë të konsiderueshme. Akoma më tej në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar asnjë minimum eksperience për asnjë punonjës ndërkohë eksperiencat e prezantuar të punonjësve të stafit të OE dëshmojnë për përvojë të gjatë profesionale. Komisioni sqaron autoritetin kontraktor, se, vlerësimi është i matshëm në kushtet kur, niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me stafin, duke përfshirë shumë elementë të tillë si numri i personelit, eksperiencë, profesionet, vitet e punës pranë shoqërisë ankimese, etj. Komisioni gjykon se vlerësimi dhe gjykimi i komisionit të vlerësimin të ofertave, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime me ndryshime të dukshme e të thella, në kushtet kur, dukshëm operatori ekonomik provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion të mjaftueshëm për t'u mos u vlerësuar me pikët minimale. Komisioni, gjykon se,

procesi i pikëzimit në procedurat e punëve, duhet të bëhet në përputhje edhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, vlerësimi i dhënë nga specialistët e KVO lidhur me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor lidhur me stafin e kualifikuar në fushën e zbatimit në ndërtim, për operatorin ekonomik ankimues nuk është i arsyeshëm dhe jo në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ky i fundit, dhe për arsye duhet të kryejë rivlerësim me pikë për operatorin ekonomik ankimues "PE-VLA-KU" SHPK.

*b.- Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]*  
Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "PE-VLA-KU" SHPK dhe boe "ARIFAJ" SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K., si edhe vendimt të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës duke përcaktuar në mënyrë të përgjithshme departamentet dhe personat përgjegjës të kompanisë. Asnjë nga ofertuesit nuk ka dëshmuar me dokumentacion metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetren, me mbikëqyrësin e punimeve dhe me autoritetin kontraktor si dhe nuk kanë parashtruar asnjë argumentim mbi sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë dhe për arsye janë vlerësuar të gjithë me 1 pikë nga ana e autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

### **III.5.10. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [10 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [5 pikë]

Për të tre nënkriteret e sipërcituara, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues "PE-VLA-KU" SHPK dhe boe "ARIFAJ" SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K., si edhe vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë paraqitur materiale për propozimet për uljen e ndikimit në mjedis. Ata në materialet e tyre respektivë, kanë përcaktuar dhe përshkruar masa të përgjithshme që do të ndërmarin gjatë ndërtimit për minimizimin e ndikimit në mjedis në zonën ku do të zhvillohet objekti. Gjithashtu, kanë hartuar masa për menaxhimin mjedisor, masa për menaxhimin e mbetjeve etj. Nga ofertuesit janë paraqitur propozime për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës si dhe janë përcaktuar



masa të përgjithshme që do të ndërmarren gjatë implementimit të projektit. Bazuar në këto propozime të gjithë operatorët janë vlerësuar me 4 pikë, për secilin nënkriter. Në këtë kontekst, Komisioni gjykon se, vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit teknik është i mjaftueshëm ndërsa argumenti i operatorit ekonomik ankimues për një vlerësim maksimal për këtë komponent nuk rezulton të jetë i bazuar. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, një vlerësim i arsyeshëm për të cilin Komisioni gjykon të mbetet i pandryshuar. Procesi i pikëzimit në procedurat e tilla duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në lidhje me procedurën e prokurimit objekt - ankimi, në datën 08.05.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit të sipërcituar. Në datën 29.05.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave. Në datën 05.06.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim Fituesi Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 30, datë 10.06.2024. Referuar këtij njoftimi, fitues i kësaj procedure prokurimi është shpallur boe “ARIFAJ” SHPK & Eurokos Holding Sh.P.K. Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor si dhe nga verifikimi i veprimeve të autoriteti kontraktor në systemin e prokurimit elektronik (SPE), Komisioni konstatoi se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës objekt ankimi me datë 20.06.2024, e pasqyruar kjo dhe e dokumentura nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në dokumentacionin e dërguar në KPP.

Për sa më sipër, në lidhje me formular ankesën e paraqitur nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik nuk është shprehur dhe nuk ka dalë me asnjë vendim. Në këto kushte, procedura e prokurimit objekt - ankimi, ka qenë e pezulluar, në zbatim të pikës 2 të nenit 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapa të tjera procedural duke mbajtur procesverbal rivlerësimi të datës 20.06.2024, të nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Në konceptin juridik, “Pezullimi” është një moment juridik që ndërpret në mënyrë të menjëhershme dhe për një kohë të caktuar fuqinë juridike të aktit (në rastin konkret veprimet e autoritetit kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit). Në nenin 108 të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

parashikon, se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.” Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet, se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”.

Për më tepër, referuar nenit 111 të LPP, pika 1, i cili parashikon se: “Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”, ndërsa në pikën 2 të nenit 112 të LPP i cili parashikon se: “2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

Në pikën 2 të nenit 114 të LPP i cili parashikon se: “Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre” dhe pikës 2 të tij “2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar”. Pra, autoriteti kontraktor me konfirmimin e marrjes së formularit të ankesës pranë KPP, pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik, përveç rastit kur autoriteti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera...”

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin, duke shkelur përcaktimet e pikës 2, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi me marrjen e ankesës, autoriteti kontraktor kishte pezulluar procedurën e prokurimit dhe nuk duhet të kishte kryer asnjë veprim deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Komisioni i Prokurimit Publik, pasi referuar konstatimeve të këtij vendimi, nuk janë garantuar dhe respektuar parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

*Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-99889-04-02-2024, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së vjetër Kombinat - Ndroq - Plepa, Loti I”, me fond limit **754,965,352.17** (shtatëqind e pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy pikë shtatëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 7,354,036.16** (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar në datën 08.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK për procedurën e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ULZA” SHPK & “PEPA GROUP” SHPK & “ALMO KONSTRUKSION” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PE-VLA-KU” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**